

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin e vetëm gjykues Rrustem Begolli, me sekretaren juridike Sanije Troshupa, në çështjen penale kundër të pandehurit M.S., nga P., për shkak të veprës penale Ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 379 par. 1 të KPRK-së, i akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.6433/2017, të dt:26.04.2018, duke vendosur lidhur me kërkesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë për dhënien e urdhrit ndëshkimor PP.II.nr.6433/2017, të dt:26.04.2018, më **14.06.2018**, jashtë seancës, mori këtë:

A K T G J Y K I M

PRANOHET kërkesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë/Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.6433/2017, të dt:26.04.2018, dhe gjykata nxjerr këtë:

URDHËR NDËSHKIMOR

I pandehuri:

M.S.: nga i ati N., e ëma H., e gjinisë K., i lindur me datë ..., me vendbanim në rrugën “Xh.A.”, me numër personal ..., me numër të tel. ..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

S e p s e:

Me datë 16.10.2017, i pandehuri M.S., rreth orës 02:00h, në P. në udhëkryqin në mes të rrugëve N.G., Sh.R., L.G. dhe Xh.A., ka drejtuar automjetin e tipit “VW Passat”, me ngjyrë të hirt metalike me targa..., në gjendje të paaftë, nën ndikimin e alkoolit, me ç’rast shkakton vet aksident ashtu që me veturën e tij, përplasat me shtyllën elektrike dhe si pasojë kishte pësuar dëme materiale në veturën e tij;-

Me këtë ka kryer veprën penale, Ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 379 par. 1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata në bazë të neneve 7, 17, 23, 41, 43, 46 të KPRK-së, si dhe neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, të pandehurit M.S. i shqipton këtë:

DËNIM ME GJOBË

I pandehuri: **M.S.** dënohet me gjobë në shumë prej **300.00 € (tre qind euro)**, të cilën dënim është i obliguar që ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Nëse dënimi i shqiptuar në të holla nuk mund të ekzekutohet, gjykata të njëjtin do ta ekzekutoj duke i caktuar nga 1 (një) ditë burgimi për 20 (njëzet) €, të gjobës.

Obligohet i pandehuri që të paguaj shpenzimet procedurale dhe atë për ekspertizën e komunikacionit shumë prej **40.88€** si dhe paushallin gjyqësor në shumë prej **20€**, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, me PP.II.nr.6433/2017, të dt:26.04.2018, ka akuzuar M.S., se ka kryer veprën penale – Ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 379 par. 1 të KPRK-së, dhe njëherësh nga gjykata ka kërkuar dhënien e urdhrin ndëshkimor, me arsyetimin se ka prova të mjaftueshme dhe të besueshme nga kallëzimi penal, lidhur me arsyeshmërinë e akuzës së propozuar në drejtim të vërtetimit të fakteve, se i pandehuri ka kryer veprën penale, për të cilën akuzohet.

Gjyqtari i vetëm gjykues, me rastin e shqyrtimit paraprak të çështjes, konform nenit 493 të KPPRK-së, gjeti se janë plotësuar kushtet nga neni 495 të KPPRK-së, dhe pranoi kërkesën për dhënien e urdhrin ndëshkimor si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Kjo gjykatë konsideron se provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës, dhe atë: kallëzimi penal i Policisë së Kosovës nr.2017-AR-2736 të datës 16.10.2017, Raporti mbi Legalizimin e Pranisë së Alkoolit në Organizëm, ekspertiza e ekspertit të komunikacionit ing. A.M. të datës 03.04.2018, deklarata e të pandehurit e dhënë në procedurën paraprake, si dhe shkresat e tjera të lëndës janë prova të besueshme mbi bazën e të cilës vërtetohet se i pandehuri ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lartë, gjykata konstaton se i pandehuri M.S., është penalisht përgjegjës për kryerjen e veprës penale Ngasje në gjendje të paaftë apo të dehur nga neni 379 par. 1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit i përmbajnë elementet e kësaj vepre penale.

Me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, gjykata u ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit sipas nenit 74 të KPRK-së.

Vendimi për kompensimin e shpenzimeve të procedurës dhe paushallit gjyqësor, është marrë në bazë të nenit 450 par. 2 pika 2.6 të KPPRK-së.

Nga sa u tha më lartë, e në bazë të neneve 365 dhe 495 të KPPRK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË-DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM
P.nr.1987/2018 të dt. 14.06.2018

**Procesmbajtësja,
Sanije Troshupa**

G j y q t a r i
Rrustem Begolli

KËSHILLA JURIDIKE:

Të pandehurit ose mbrojtësit e tyre, në afat prej (8) ditëve, pas pranimit të këtij aktgjykimi–urdhri ndëshkimor, mund të paraqesin kundërshtim me shkrim ose me gojë.